



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:081505

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05436826

Ac.nr.5800/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Adnan Konushevcu kryetarë i kolegjit, Halide Reka dhe Naime Ahmeti, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike jokontestimore të propozuesve H dhe Sh.K, nga fshati S.P, Komuna në V..., të cilët me autorizim i përfaqëson Fatmire Braha, avokate nga Komuna në Vushtrri, Rruga “Hasan Prishtina”, Nr.62, kundër propozuesit Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH - Organi Shpronësues), me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim Muharrem Kurtaj, avokat nga avokatura shtetërore, lidhur me caktimin e kompensimit për pasurinë e ekspropriuar, duke vendosur lidhur me ankesën e kundër propozuesit të paraqitur kundër aktvendimit CN.nr.93/2020 datë 01.07.2021, i Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e kundër propozuesit, Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH - Organi Shpronësues), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi CN.nr.93/2020 datë 01.07.2021, i Gjykatës Themelore Mitrovicë - Dega në Vushtrri, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar CN.nr.93/2020 datë 01.07.2021, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET si e bazuar ankesa e propozuesve H.K dhe Sh.K nga fshati S.P, Vushtrri, ndaj kundër propozueses Qeveria e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, - Organi shpronësues, me seli në Prishtinë, për shkak të caktimit të kompensimit në emër të diferencës për shpronësim të pronës së paluajtshme ashtu që NDRYSHOHET Vendimi Përfundimtar nr.02/06 i datës 10.03.2020 dhe Raporti-Akti i Vlerësimit i datës 12.11.2019, i Qeverisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, për caktimin e kompensimit në emër të shpronësimit të parcelës kadastrale të propozuesve nr.1168K-0 me sipërfaqe të*

shpronësuar prej 306 m2 dhe parcelën katastrale nr.1169K-0, me sipërfaqe të shpronësuar prej 78 m2, që të dy parcelat në Z.K P..., Komuna e Vushtrrisë, ashtu që:

II. CAKTOHET kompensimi në emër të diferences për pasurinë e paluajtshme të propozuesve H.K dhe Sh.K nga fshati S.P, Vushtrri, në emër të shpronësimit të parcelës kadastrale nr.1168K-0 Z.K P..., Komuna e Vushtrrisë, me sipërfaqe të shpronësuar prej 306 m2, në shumën prej 25.290 euro dhe për parcelën katastrale nr.1169K-0, Z.K P..., Komuna e Vushtrrisë, me sipërfaqe të shpronësuar prej 78 m2, në shumën prej 4290 euro dhe:

III. OBLIGOHET kundërpropozuesja Qeveria e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor me seli në Prishtinë, që propozuesve H.K dhe Sh.K nga fshati S.P, Vushtrri, në emër të diferencës së cmimit kompensimit të shpronësimit për pronën e paluajtshme në parcelën katastrale nr.1168K-0 Z.K P..., Komuna e Vushtrrisë, me sipërfaqe të përgjithshme të shpronësuar prej 306 m2, të ua paguaj shumën prej 25.290 euro si dhe për parcelën katastrale nr.1169K-0, Z.K P..., Vushtrri, me sipërfaqe të përgjithshme të shpronësuar prej 78 m2, të ia paguaj shumën prej 4290 euro, me kamatë ligjore prej 7 % vjetore duke llogaritur nga dita e parashtrimit të ankesës me datën 07.07.2020 e gjerë në pagesën definitive të detyrimit.

IV. OBLIGOHET kundërpropozuesja Qeveria e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor-Departamenti i Shpronësimit, me seli në Prishtinë, që në emër të pagesës për shpenzimet e kësaj procedure, propozuesit t'ia paguaje shumen e përgjithshme prej 1419.20 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit”.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, kundër propozuesi ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës jo kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të miratohet ankesa e kund rpropozuesit - Organi Shpronësues dhe aktvendimi i kësaj Gjykate të shfuqizohet.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se propozuesit, me datë 07.07.2020, kanë paraqitur propozim për caktimin e shpërblimit të paluajtshmërisë së shpronësuar ndaj kundër propozuesit.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, deklarimit të palëve në procedurë ka nxjerrë aktvendimin CN.nr.93/2020 datë 01.07.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar propozimin e propozuesve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas vlerësimit dhe administrimit të provave propozimin e propozuesit e miratoj në tërësi si të bazuar dhe e detyroi kundërpropozuesin që për parcelën katastrale nr.1168K-0 Z.K P..., Komuna e Vushtrrisë, me sipërfaqe të përgjithshme të shpronësuar prej 306 m², të ua paguaj shumën prej 25,290.00 euro, si dhe për parcelën katastrale nr.1169K-0, Z.K P..., Vushtrri, me sipërfaqe të përgjithshme të shpronësuar prej 78 m², të ia paguaj shumën prej 4,290.00 euro, në emër të kompensimit, për diferencën për pjesën e shpronësuar, të cilat shuma janë caktuar, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit vlerësues, si dhe duke u bazuar në sqarimet e dhëna të ekspertit, në seancën e datës 14.06.2021, gjykata kësaj ekspertize ia kishte falur besimin e plotë sepse e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale, palët të njëjtën e kanë pranuar dhe nuk kanë dhënë vërejtje në atë ekspertizë si dhe nuk është propozuar ndonjë ekspertizë e re.

Më tutje gjykata ka theksuar se meqenëse kundër propozuesi ka rënë në vonesë me pagimin e kompensimit, gjykata me kërkesën e të autorizuarit të propozuesit dhe në bazë të nenit 16 par.2 pika 2.2 të Ligjit për Shpronësimin, e detyroi kundër propozuesin që propozuesit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 7%, interes i thjesht vjetor, duke filluar prej datës 07.07.2020, dita e parashkrimit të ankesës në gjykatë, e deri në pagesën definitive. Po ashtu gjykata pas analizimit të pretendimeve të autorizuarit të propozuesit, i cili i kishte propozuar gjykatës që propozimi të miratohet në tërësi si i bazuar të njëjtave ua kishte dhënë besimin dhe vendosi si në dispozitiv të aktvendimit, sepse pjesë e ngastrave kadastrale të propozuesit të shënuara më lartë janë eksproprijuar, nuk janë vlerësuar sipas çmimit të tregut.

Gjykata e shkallës së parë kishte analizuar edhe pretendimet tjera të palës kundër propozuese mirëpo të njëjtat nuk ndikuan në marrjen e një vendimi ndryshe, dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të

dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, konform nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk ekzistojnë as shkeljet e Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Gjykata e Apelit, vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor se kemi të bëjmë me shkelje të procedurës, nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës jokontestimore, gjithashtu gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të plotë, ndërsa e drejta materiale është aplikuar drejtë.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e kundër propozueses janë të pa specifikuara në drejtim të shkeljeve qoftë të aspektit procedural, gjendjes faktike apo zbatimit të së drejtës materiale. Pretendimet ankimore më tepër i referohen arsyetimeve të shpronësimit dhe procedurës që e ka ndjekur organi shpronësues në pronën në fjalë, mënyrën se si është vlerësuar, sesa përmes tyre që është goditur specifikisht aktvendimi i atakuar edhe pse në hyrje të ankesës ky aktvendim goditet nga të gjitha bazat.

Gjendja faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pasi në raport me identifikimin e sipërfaqeve të shpronësuara është vërtetuar nga certifikatat e palujtshmërive që gjenden në shkresat e lëndës, se këtu propozuesit janë pronarë të të sipërfaqeve të shpronësuar në këtë rast, ndërsa përcaktimi i çmimit të vlerës financiare – diferencës, për pjesët e shpronësuar.

Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin ekspertizës vlerësuese të palujtshmërisë/pronës së shpronësuar, pasi që nga mendimi i ekspertit Hajrullah Muli, të dhënë në raportin vlerësues të datës 23.03.2021 si dhe sqarimeve të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.06.2021, me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, se ekspertiza në fjalë është profesionale, duke vlerësuar se eksperti në fjalë ka dhënë mendim profesional me shkrim dhe real, dhe në mënyrë të gjithanshme për paluajtshmërinë lëndore, dhe duke përdorë metoda krahasuese janë marr për bazë të gjitha provat që kanë pasur mundësi të disponon me to eksperti dhe ajo që është më e rëndësishme si dhe sqarimeve në seancë nga ana e ekspertit, më pastaj shpronësimet e pronave me elemente të njëjta dhe mbi bazën e metodave krahasuese ka ardhur deri te lartësia sikurse ajo e cekur në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Mendimi i ekspertit

ishte i mbështetur në të gjitha elementet, të njëjtat me të drejtë janë vlerësuar të besueshme sepse kanë trajtuar në detaje të gjitha elementet e pronës, dhe kanë arritur të një përfundim real i përcaktimit të pronës sikurse është vendos në aktvendimin e atakuar. Pra me rastin e përpilimit të ekspertizës vlerësuese janë përfillur metodat adekuate dhe krahasuese për të nxjerr çmimin adekuat.

Kundër propozuesja ka pasur mundësinë që të kontestojë ekspertizën e ekspertit për vlerësimin e pronës, gjatë procedurës pranë Gjykatës së shkallës së parë e një gjë të tillë nuk e ka bërë, kundërpropozuesja edhe pse e ka pas mundësinë që të propozon nuk ka propozuar ekspertizë të re për vlerësim, në raport me çështjen në fjalë. Po ashtu edhe në ankesë kundër propozuesi nuk i atakon përmbajtësish ekspertizat por të njëjtat vetëm i krahason me mendimin apo vlerësimin e organit shpronësues, gjë që edhe pretendimet ankimore i bënë të pa qëndrueshme.

Gjykata, me rastin e vendosjes në këtë rast, vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por të njëjtat nuk janë kanë qenë me ndikim për të vendosur ndryshe.

Ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike jo kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve, si për përfaqësime ashtu edhe për taksa gjyqësore dhe ekspertiza e gjithashtu është në harmoni me dispozitat e LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, e lidhur me nenin 3 të LPJ-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5800/2021 me datë 08.03.2024

Kryetar i Kolegjit
Adnan Konushevc i d.v.